

Bujqesia per Metalet


Life AGROMINE synon të demonstrojë një qasje të qëndrueshme për rikuperimin e nikelit (Ni) nga bimët për qellime ekonomike. Qasja bazohet në përdorimin e bimëve akumulatore të nikelit, të cilat ekstrahojnë nikelin nga toka dhe e grumbullojnë atë në pjesët mbitokësore të bimes. Pas korrjes dhe djegies së bimëve, nga hiri nepermjet një proces hidrometallurgjik perfitohet Nikeli.

Projekti është në përputhje me konceptin e ekonomisë rrethore dhe krijon një biznes të ri që synon të rikuperojë metale me vlerë të lartë si nikeli.



Hiperakumulatoret e metaleve, p.sh. siç janë Leptoplax emarginata dhe Alyssum murale, tregojnë një sjellje shumë të pazakont, ata janë në gjendje të grumbullojnë metale specifike në gjethet dhe kercëjt të tyre pa treguar efekte toksiciteti.

Përqendrimet e metaleve në këto bimë shpesh janë 100 - 1000 herë më të larta se në jo akumulatoret dhe deri në 10 herë më të larta se në vetë tokën. Metalet merren nga toka dhe transportohen në mënyrë aktive në biomasën mbitokësore të bimeve.



Source: Baptiste Laubie

Ky proces quhet 'Agromining' dhe mund të aplikohet në çdo tokë ose substrat tjetër të pasur me nikel. Shkenca e tokës, agronomia dhe inxhinieria kimike kontribuojnë në zhvillimin e kësaj teknologjie.

Të dhënat e reja në kuadrin e projektit Life-Agromine rikonfirmojnë potencialin e hiperakumulatoreve Ni me maksimum >150kg/ha për të zhvilluar një sistem më të mirë rritje për teknologjinë e fitoekstraktimit të metaleve

- 145 kg/ha, 106 kg/ha *Alyssum murale* (Shqipëri, Greqi)
- 89 kg/ha *Bornmuellera tymphaea* (Greqi)
- 151 kg/ha *Leptoplax emarginata* (Greqi)

Perse te rikuperojme Metalet tona ?

Kërkesa në mbarë botën për nikel (Ni) po përjeton një rritje të paparë nën presionet aktuale industriale dhe ekonomike. Partneriteti Evropian i Inovacionit e klasifikoi Ni si një lëndë të parë me një rëndësi të lartë ekonomike. Sidoqoftë, prodhimi i minierave kryesisht bëhet jashtë Bashkimit Evropian. Tokat e pasura me nikel, siç janë toka ultramafike ose serpentinë (jo tërheqese për bujqësinë për sa i përket pjellorisë dhe produktivitetit) janë braktisur nga fermerët vendas, por kanë një potencial të lartë për rikuperimin e metaleve të ekstraktuara nga bimët me aplikimin e proceseve metalurgjike.

Kërkohen urgjentisht teknologji për të shfrytëzuar burimet parësore, siç janë tokat ultramafike, në të cilat Ni është i pranishëm në nivele të konsiderueshme (1500-4000 mg / kg), por kur nxjerrja e tij nga proceset e minierave konvencionale nuk është ekonomikisht e vlefshme.

Konvertimi i metalit që gjendet në bimët hiperakumulative në komponime të nikelit, sidoqoftë, është një alternativë premtuese për fermerët dhe industrinë e përpunimit të Nikelit.

Ju keni të gjithë nikel në duart tuaja. Cdo monedhë prej 1 dhe 2 eurosh është e gjitha prej nikeli dhe disa lidhjeve të saj. Kur është i pastër, nikeli duket i argjendtë.

Nikeli përdoret gjerësisht për industri. Përdoret në rreth 3000 lidhjeve për 250000 aplikime p.sh. në industrinë e automobilave, bateri dhe pajisje elektronike të rimbushshme, prodhim dhe përdorim të çelikut inox, katalizatorë, produkte luksi dhe arti.

Ky proces quhet 'Agromining' dhe mund të aplikohet në çdo tokë ose substrat tjetër të pasur me nikel. Shkenca e tokës, agronomia dhe inxhinieria kimike kontribuojnë në zhvillimin e kësaj teknologjie.

Implementimi i parcelave bujqësore në shkallë pilot - Shqipëri, Austri, Greqi, Spanjë



- Shqipëria:** Aida Bani
+35 5692467488 / aida_alushi@hotmail.com
- Austri:** Markus Puschenreiter
+01 4765491162 / markus.puschenreiter@boku.ac.at
- Belgjikë:** Tom Kuppens
+32 11268755 / +32 473516873 / tom.kuppens@uhasselt.be
- Francë:** Guillaume Echevarria +33 372744125
Guillaume.Echevarria@univ-lorraine.fr
Claire Hazotte +33 354505240 / contact@econick.fr
- Greqi:** Evgenia Tsianou
+30 6978600342 / office.greece@alchemia-nova.net
Maria Konstantinou
+30 2521060478, +30 6977899899 / mkonst@teiemt.gr
- Spanjë:** Petra Kidd
+34 981590958 / pkidd@iiag.csic.es

<http://life-agromine.com>

<https://www.facebook.com/LifeAgromine/>



Life
AGROMINE

Bujqesia per Metalet

Kultivimi i bimëve hiperakumulative në toka të pasura me nikel dhe mbetje për sintezën e gjelbër të komponimeve të nikelit të pastër



Projekti AGROMINE është mbështetur nga programi Life I Bashkimit Evropian
LIFE15 ENV/FR/000512